



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 508/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Deçanë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhorë (KKZ) dega në Deçan për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Deçanë

#### **Arsyetim**

Me datën 04.11.2013, LVV-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, sot në mëngjes në gjysmë të rrugës, në mes Deçanit dhe fshatit Strelc një furgon i cili ka qenë i mbushur me material sensitiv zgjedhorë është nisur pa përcjelljen e policisë. Më tutje ka shtuar, pasi që ky rast është kuptuar nga një zyrtar policor, furgoni është kthyer me përcjellje të policisë pa mbërritur në vendvotim. Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor andaj ka kërkuar që rasti të procedohet .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Me ankesën e parashtruar nga LVV-ja pretendohet se kanë ndodhur pa rregullsi dhe mundësi të keqpërdorimit me rastin e bartjes së materialit zgjedhor, sepse veprimet e kryera nuk kanë qenë në mbikëqyrje të policisë së Kosovës, mirëpo një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i paqartë për tu vërtetuar .

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, pasi që mungojnë provat me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 508/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**

***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

